



KOMITETI DREJTUES

Nr. 69 Prot.

Tiranë, 17 Tetor 2023

Vendim Nr. 7 i KD-së

Komiteti Drejtues i FSHB-së në mbledhjen më datë 17 tetor 2023, drejtuar nga Presidenti, Z. Avni Ponari dhe prezencë të anëtarëve, Znj. Edera Alibegaj, Znj. Migena Plasa, Z. Juel Jarani, Z. Blendi Dibra dhe Z. Klevis Kaso, duke formuar kuorumin e domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes, diskutuan mbi rendin e ditës si vijon:

1. Dorëheqja e Sekretarit të Përgjithshëm;
2. Shorti JrNBA;
3. Kampionatet kombëtare U18/16 Djem dhe Vajza 2023-24;
4. Organizimi i Superkupës (M-F) 2023;
5. Organizimi i Kupës "Gazmend Çaçi" 2023;
6. Pjesëmarrja me ekipet kombëtare 2024;
7. Projekti "Sport për Zhvillim" - KOKSH
8. Të ndryshme.

Komiteti Drejtues diskutoi sipas rendit të ditës duke trajtuar problematikat për secilën pikë të sajë. Trajtoi kërkesën për dorëheqje e Sekretarit të Përgjithshëm, z. Korab Llazani, si dhe u diskutuan kriteret për shpalljen e thirrjes për garën e hapur të pozicionit të Sekretarit të Përgjithshëm të FSHB-së. Diskutoi shortin për Jr.NBA Albania 2023. Rakordoi organizimin e kampionateve kombëtare U18/16 Djem dhe Vajza 2023-24. Diskutoi aplikimet për organizimin e Superkupës (M-F) 2023. Rakordoi zhvillimin e Kupës "Gazmend Çaçi" 2023, për kategorinë U18 djem. Trajtoi pjesëmarrjen në projektin e KOKSH – "Sport për Zhvillim", si dhe të ndryshme. U diskutua lidhur me mbledhjen e KD-së, datë 15 shtator 2023, mbi pasqyrimin e zbardhjes së mbledhjes në fjalë, në të cilën nuk mund të përfshihej një nga vendimet që lidhej me humbjen e mandatit si anëtar i KD-së për z. Juel Jarani, bazuar në nenin 28 pika 8 të Statutit të FSHB-së, ku saktësohet se mungesa 3 herë rradhazi pa arsye të forta e një anëtar i KD-së në mbledhjet e sajërezulton me humbjen e mandatit.

Për sa më sipër KD-ja vendosi:

1. Pranimin e dorëheqjes së Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe shpalljen e pritjes së aplikimeve për pozicionin e Sekretarit të Përgjithshëm të FSHB-së për një periudhë dy javore, duke vendosur kriteret e parashikuara në Statutin e FSHB-së, si dhe ndër të tjera, domosdoshmërinë e njohjes së gjuhës angleze dhe frënge në nivel shumë të mirë;
2. Realizim i shortit të JrNBA Albania 2023 sipas axhendës të përgatitur;
3. Organizimi i kampionateve kombëtare U18/16 Djem dhe Vajza 2023-24 duke i përfshirë në një kategori, si dhe për ndeshjet e sezonit të rregullt duke i ndarë në grupe sipas numrit të ekipeve pjesëmarrëse dhe vendodhjes gjeografike;

4. Superkupa (M-F) do të organizohet gjatë muajit nëntor 2023.
 - 4.1 Superkupa meshkuj do të organizohet në pallatin e sportit “Ramazan Njala”, Durrës, nën kujdesin e shoqatës Teuta Basket duke siguruar detyrat organizative të bëra me dije në shpalljen e pritjes së aplikimeve për organizim. Data dhe ora do të rakordohen në vazhdim.
 - 4.2 Superkupa femra do të organizohet në pallatin e sportit “Feti Borova”, Tiranë, nën kujdesin e shoqatës Partizani Basket. Data dhe ora do të rakordohen në vazhdim.

5. Organizimi i Kupës “Gazmend Çaçi” 2023, për kategorinë U18 djem, 25-29 nëntor 2023, me pjesëmarrjen e të gjitha ekipeve që do të plotësojnë dokumentacionet. Ndeshjet do të jenë me format eliminimi dhe do të organizohen në pallatin e sportit “Tomorr Sinani”, Elbasan;

6. Miratim i pjesëmarrjes me ekipet kombëtare për vitin 2024 si më poshtë:
 - U20 Djem dhe U20 Vajza – Divizioni B;
 - U18/16 Djem dhe U18/16 Vajza – Divizioni C;
 - *Turneu europian U16 djem, divizioni C, do të organizohet në pallatin e sportit “Dhimitraq Goga”, Durrës, sipas miratimit nga FIBA për vitin 2024.
 - Ekip kombëtar femra të rritura në aktivitetin ndërkombëtar për “Small Country”, 20-30 qershor 2024.

7. Pjesëmarrje në projektin e KOKSH – “Sport për Zhvillim”, datë 28 tetor 2023, Thumane.

8. Të ndryshme:
 - 8.1 Pasi janë verifikuar zbardhjet e vendimeve të Komitetit Drejtues, vendimi mbi humbjen e mandatit të z. Juel Jarani anulohet dhe nuk pasqyrohet në vendimet e marra të mbledhjes së datës 15 shtator 2023, duke qënë se nuk është me bazë sipas nenit 28 pika 8 të Statutit të FSHB-së.
 - 8.2 Dixhitalizim i sallave sportive në të gjithë Shqipërinë ku mund të zhvillohet sporti i basketbollit, si dhe vendosja e një personi kontakti me pagesë mujore për secilin rreth në territorin e Shqipërisë, përgjegjës për monitorimin e aktiviteteve basketbollistike me moshat dhe identifikimin e talentëve;
 - 8.3 Kujtesë shoqatave anëtare dhe trajnerëve për aplikimin për staf teknik të ekipeve kombëtare 2024;
 - 8.4 Vendosjen e pagës në vlerën neto për specialistët e administratës së FSHB-së duke filluar nga muaji nëntor 2023, si më poshtë:
 Gerald Osmani – 80’000 lek;
 Ajla Gozhdari – 60’000 lek;
 Ersi Oruçi – 60’000 lek.